



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 3515/14 Prot.

Tiranë, më 19.12.2023

V E N D I M

Nr. 141 datë. 19.12 2023

PËR
LËVIZJEN PARALELE TË 1 (NJË) PUNONJËSI, PERSONEL AKADEMIK NGA
DEPARTAMENTI I LËVIZJES DHE SHËNDETIT NË DEPARTAMENTIN E
AKTIVITETIT FIZIK, REKREACIONIT DHE TURIZMIT PRANË FAKULTETIT
TË VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

Mbështetur në Ligjin nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së neni 25, gërma d), në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL”, në Vendimin e Senatit nr.6, datë 27.01.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023” të ndryshuar, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 7, datë 01.02.2023 “Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike, dhe klasifikimit të pagës për vitin 2023”, të ndryshuar, në shkresën e Dekanatit të FVFR me nr. 3475/1 prot., datë 18.12.2023 “Për kalimin paralel të Prof.Asc.Dr. Ferdinand Mara, pranë Departamentit të Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit në FVFR”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.12.2023,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lëvizjes paralele të **Prof.Asc.Dr. Ferdinand Mara**, Dekan i FVFR, personel akademik në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit, kalon në strukturë në Departamentin e Aktivitetit Fizik, Rekreacionit dhe Turizmit, pranë Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.
2. Miratimi i kësaj lëvizje nuk prek strukturën dhe organikën e njësisë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim t’i përcillet për miratim Bordit të Administrimit të UST.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA

